



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORATI PËR ARSIM
Dt. 18.10.2022, Nr. 09-11/01-53 613



Në bazë të nenit 64 pika 1 e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtaret Publikë të Republikës së Kosovës, në vështrim të nenit 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, Udhëzimit administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ (MASHTI) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ(MASHT)Nr. 05/2015 normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Drejtorati për Arsim në Drenas, shpallë:

K O N K U R S

1. SHFMU” Naim Frashëri ” në Gllobar

- Një mësimdhënës/e për arsim fillor, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit mjekësor, më mundësi vazhdimi.

2. SHFMU” Naim Frashëri ” në Gllobar

- Një mësimdhënës/e për Edukatë Qytetare më 13 orë, prej tyre 4 orë në SHFMU” Naim Frashëri ” në Gllobar + 4 orë në SHFMU” Regjep Gjeli “ në Likoshan + 3 orë në SHFMU” Luigj Gurakuqi “ në Sankoc dhe 2 orë në SHFMU” 24 Korriku “ në Fushticë e Poshtme, për vitin shkollor 2022/2023, më mundësi vazhdimi.

3. SHFMU “ Luigj Gurakuqi “ në Sankoc

- Një mësimdhënës/e për Art Figurativ me 10 orë, prej tyre 4 orë SHFMU “ Luigj Gurakuqi “ në Sankoc + 4 orë në SHFMU “ Regjep Gjeli” në Likoshan, 2 orë në SHFMU “ Jusuf Gërvalla “ në Negroc, për vitin shkollor 2022/2023, më mundësi vazhdimi.

4. SHFMU” Xheladin Gashi – Plaku ” në Komaran

- Një mësimdhënëse për TIK më 12 orë, për vitin shkollor 2022/2023, më mundësi vazhdimi.

5. SHFMU” Migjeni ” në Baicë

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit mjekësor, lehonisë.

6. SHFMU” Ali Gashi ” në Çikatovë të Re

- Një mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze, deri sa të kthehet punëtorja prej pushimit mjekësor, lehonisë.

7. SHML “ GJ.K.Skënderbeu “ në Drenas

- Një pedagog/e, më kohë të pacaktuar.

KUSHTET E PUNËSIMIT:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet përgatitje adekuate profesionale (me fakultete përkatëse), sipas U.A.05 / 2021 – MASHTI, U.A. 06/2021 – MASHTI.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM:

1. Aplikacioni i punësimit.
2. Kopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, patentë shofer ose pasaportë)
3. Diploma ose Çertifikata e diplomimit- jo më e vjetër së gjashtë muaj, e vërtetuar ne Komunë ose te Noteri publik.
4. Çertifikatë origjinale që nuk është nën hetime, ose e noterizuar, jo më e vjetër së gjashtë muaj.
5. Vërtetim i përvojës së punës vetëm në arsim (nëse keni).
6. Çertifikatë mjekësore për gjendjen shëndetësore lidhur me çështjen e punësimit, për kandidatët që pranohen në punë.
7. Kopje të Çertifikatave të trajnimeve përkatëse (nëse keni)

REKRUTIMI:

Intervistat me shkrim më gojë dhe përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë Komisioni i përzgjedhur nga DKA.

VËREJTJE:

Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së, të plotësohet rrjedhshëm në gjuhën shqipe dhe me shkronja të mëdha të shtypit, dokumentacioni i kompletuar dorëzohet në Arkivin Komunal, ndërsa dokumentet e pakompletuara, ato që arrijnë pas afatit të konkurrimit dhe dokumentet shtesë jashtë dorëzimit në arkiv nuk pranohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Drenas,
Më:18.10.2022



Drejtör për Arsim

Muhamet Gjoka